



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 417/ 6 prot.

Datë 05.04.2023

V E N D I M
Nr. 250/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05.04.2023, shqyrtoi kërkesën me:

- Objekt:** Kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës nr. 417 prot., datë 16.02.2023, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-47793-10-28-2022, me objekt “*Ndërtimi i shëtitorës “Bashkim Gazidede” Bathore*”, me fond limit 45,833,333 (*dyzet e pesë milion e tetëqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre*) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 15.11.2023 nga autoriteti kontraktor Bashkia Kamëz..
- Ankimues:** Bashkimi operatorëve ekonomikë “*Euro-Alb*” SHPK & “*Murati*” SHPK
Adresa: Rruga “*Spitalit*”, Lagjia “*Minatori*”, Pallati nr. 12, Shk. 1, Kati 5, Ap. 15, Bulqizë.
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Kamëz
Adresa: Bulevardi “*Nënë Tereza*”, Nr. 492, Kamëz, Tiranë.
- Baza Ligjore:** Nenet 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit

Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020, datë 05.11.2020 “Rregullore për marrjen e masave organizative për ushtrimin e veprimtarisë së institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi kërkesën e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 31.10.2022, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-47793-10-28-2022, me objekt “Ndërtimi i shëtitores “Bashkim Gazidede”Bathore”, me fond limit 45,833,333 (dyzet e pesë milion e tetëqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 15.11.2023 nga autoriteti kontraktor Bashkia Kamëz.

II.2. Në datën 27.02.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 417 prot, datë 27.02.2023, e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Euro-Alb” SHPK & “Murati” SHPK për procedurën e “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-47793-10-28-2022, me

objekt “Ndërtimi i shëtitorës “Bashkim Gazidede” Bathore”, me fond limit 45,833,333 (dyzet e pesë milion e tetëqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 15.11.2023 nga autoriteti kontraktor Bashkia Kamëz. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes “Euro-Alb” SHPK & “Murati” SHPK, në procedurën e mësipërme e prokurimit.

II.3. Me shkresën nr. 13 prot, datë 05.04.2023 protokolluar me tonën me shkresën nr. 417/5 prot, datë 05.04.2023 me përmbajtje si vijon: “Lis Konstruksion SHPK (Euro-Alb) SHPK), me nr. Nipti K66612407H, ka paraqitur njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor Bashkia Kamëz dhe Komisionit të Prokurimit Publik, ankesën me nr. 417 prot, datë 27.02.2023 për procedurën me objekt: Ndërtimi i shëtitorës Bashkim Gazidede Bathore”, me vlerë të fondit limit 45.833.333 lekë pa tvsh, me Kod CPV: 45246500-8. Për shkak të angazhimit të kapaciteteve të fuqisë punëtore dhe makinerive të shoqërisë në kontrata të reja të lidhura së fundmi, tërhiqemi nga ankesa për procedurën e mësipërme”. Pranë Komisionit Prokurimit Publik ka paraqitur kërkesën nr. 13 prot datë 05.04.2023 operatori ekonomik “Lis Konstruksion” SHPK (Euro-Alb SHPK), “i cili më datë 24.03.2023 ka celur çështjen me nr. CN-095362-03-23 në Qendrën Kombëtare të Biznesit ku ka depozituar Vendimin e asamblesë së përgjithshme të datës 23.03.2023 për ndryshimin e emrit të subjektit ishte (Euro-Alb SHPK) u bë (Lis Konstruksion SHPK)”. Operatori ekonomik “Lis Konstruksion” SHPK me anë të kërkesës së më sipër cituar kërkon të heqë dorë nga ankesa nr. 417 prot, datë 27.02.2023 për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-47793-10-28-2022, me objekt “Ndërtimi i shëtitorës “Bashkim Gazidede” Bathore”, me fond limit 45,833,333 (dyzet e pesë milion e tetëqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 15.11.2023 nga autoriteti kontraktor Bashkia Kamëz.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankimes,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me kërkesën e protokolluar me shkresën nr. 13 prot, datë 05.04.2023, të operatorit ekonomik “Lis Konstruksion” SHPK për të hequr dorë nga ankesa në lidhje me procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-47793-10-28-2022, me objekt “Ndërtimi i shëtitorës “Bashkim Gazidede” Bathore”, me fond limit 45,833,333 (dyzet e pesë milion e tetëqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 15.11.2023 nga autoriteti kontraktor Bashkia Kamëz, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në nenin 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se:

“1. Ankimuesi ka të drejtë që të tërheqë ankesën e depozituar në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Tërheqja e ankesës konsiderohet si mospranim ankese dhe ankimuesit nuk i kthehet tarifa e ankesës.

2. Në rast të tërheqjes së ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik ndërpret shqyrtimin e saj menjëherë dhe merr vendim për mbylljen e çështjes.”

III.1.2. Në nenin 105 të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“Operatori ekonomik ankimues ka të drejtë që të tërheqë ankesën e depozituar, në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Me paraqitjen e kërkesës për tërheqje, ndërpritet shqyrtimi i ankesës menjëherë. Për efekt të tarifës, ankesa konsiderohet si e mospranuar, dhe tarifa e ankesës nuk kthehet.

III.1.3. Bazuar në parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij, që në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në ankimimin e tij. Në këto kushte, nisur nga kërkesa e operatorit ekonomik ankimues për heqje dorë nga ankesa e bërë, në zbatim të pikës 2, të nenit 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik do të ndërpresë menjëherë shqyrtimin e ankesës nr. 417 prot, datë 27.02.2023, për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, si dhe do të mbyllë çështjen administrative.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të përfundojë procedimin administrativ për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-47793-10-28-2022, me objekt “Ndërtimi i shëtitorës “Bashkim Gazidede”Bathore”, me fond limit 45,833,333 (dyzet e pesë milion e tetëqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 15.11.2023 nga autoriteti kontraktor Bashkia Kamëz.

2. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga bashkimi operatorëve ekonomikë “*Euro-Alb*” SHPK & “*Murati*” SHPK.

3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri